



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më **31.10.2018**, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Nezir (Zeqir) Xhemshiti.
- II. Këmbimi sipas pikës I të këtij vendimi nënkupton këmbimin e
 1. Pronës së paluajtshme në pronësi, PSH, "rrugë", Kuvendi Komunal Prishtinë, parcela kadastrale nr. 2852-6, evidentuar në certifikatën e pronës P-71914059-02852-6, ZK Prishtinë, me
 2. Pronën e paluajtshme në pronësi të Nezir (Zeqir) Xhemshitit, pjesën e parcelës nr. 2851-6, të evidentuar në certifikatën e pronës P-71914059-02851-6, ZK Prishtinë.
- III. Para shpalljes publike të vendimit do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- IV. Këmbimi i parcelës, tokës me pronarin e cekur në pikën II, është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues në Prishtinë, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01, nr. 35-18196, dt. 03.08.2005, Propozimplanit rregullues të hollësishëm për lagjen "Kalabria" në Prishtinë, miratuar sipas Vendimit 01, nr. 031-247779, dt. 04.10.2016, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës mbi marrjen e vendimit për qasjen e plotësimin dhe ndryshimin të Planit rregullues të lagjes "Kalabria".
- V. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të kësaj pjese të parcelës do të rregullohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të parcelës së këmbyer.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastral të Komunës.



VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Pjesë përbërëse e këtij propozimi është edhe skica gjeodezike.

IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01/463/01-0263746/18, më 01.11.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Agim Kuleta'. The signature is written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'PRISHTINE' at the top, 'KOMUNES' on the right, 'I ZEA ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL' on the left, and 'PRISTINA' and 'KOSOVA' at the bottom. The stamp also features a central emblem.